



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:155963
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05603762

C- IV- 22- 0247

Paditësi: Banka e Kosovës SHA në likuidim me seli në Beograd, Republika e Serbisë, të cilën e përfaqëson avokati D C Ll nga Graçanica .

Kundër

Të paditurës: Ndërmarrja Shoqërore KB „ Përparimi ” , Horgosht e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Rr. “ Driton Hoxha ” nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me 03 prill 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar Kërkesa për Rivlerësim e paditësit Banka e Kosovës Sha n; Beograd kundër Vendimit të AKP-së – Autoritetit të Likuidimit GJI 031- 0003 , dt. 03 tetor 2013.**
- II. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 06 nëntor 2017, pranë DHPGJS, është parashtruar kërkesa për rishikimin e vendimit e paditësit, kundër të paditurit në lidhje me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL) për NSH KB „, Përparimi ’, GJI 031- 0003, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa e paditësit Banka e Kosovës me seli në Beograd për kompensimin për shkak të mos pagesës së kredisë në shumën 19,413.90 (\$) dollar Amerikan si e pa vlefshme.

Paditësi në kërkesë është deklaruar se arsyeja e refuzimit të kërkesës së paditësit nga Agjencia Kosovare e Privatizimit është për shkak se Parashtruesi i kërkesës me përgjigjen e tij nuk ka sjell dokumentacionin që ju është kërkuar nga Autoriteti i Likuidimit përmes parashtresës , për dorëzimin e dokumentacionit.

Vlerësojmë se një konkluzion i tillë është i parakohshëm nga AKP-ja, me Vendimin e saj të ankimuar dhe është në kundërshtim me parimin e vërtetimit të gjendjes faktike në procedurë dhe nisur nga kjo në procedurë duhet të vërtetohet në mënyrë të plotë gjendja faktike dhe rrethanat me rëndësi me rastin e marrjes së Vendimit .

Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij kreditore, ndër të tjera ka theksuar se dokumentacioni i Bankës së Kosovës SH A Beograd , pas vendosjes së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë , gjatë vitit 1999, dhe pas shpërnguljes së bankës nga Prishtina në Beograd, në objektin e saj në Prishtinë, ka ardhur deri te zhvendosja e dokumentacionit në një vend tjetër për të cilin pala nuk din.

Faktet në të cilat thirret Parashtruesi i kërkesës janë fakte të ditura dhe si të tilla janë notore dhe se AKP-ja në këto fakte ka dyshuar .

AKP-ja ka pasur për obligim në pajtim me dispozitën e nenit 48 të Ligjit për AKP-në, të siguroj këto prova dhe jo ta refuzoj kërkesën si të pa vlefshme .

Ka propozuar që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, të aplikon nenin 42 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës dhe ta urdhëroj AKP-në të deklarohet në lidhje me lokacionin në të cilin gjendet dokumentacioni në lidhje me kërkesën kreditore .

Ka kërkuar që Gjykata ta aprovon kërkesën për rivlerësim dhe ta anuloj Vendimin e AKP-së. Kërkesës nuk ja ka bashkangjitur asnjë provë .

Më dt. 30.11.2017, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën e mbrojtjes ndaj ankesës kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI 031- 0003, me propozim që ajo të refuzohet, si e pa pranueshme dhe /ose e pa bazuar dhe të vërtetojë (lërë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit .

AKP-ja në parashtrësë është deklaruar se NSH KB „ Përparimi Horgosht ” ka hyrë në procedurë të likuidimit më dt. 25.11.2013, ndërsa paditësi më dt. 01.01.2014, ka parashtruar kërkesën kreditore për mos pagesë të kredisë në shumën 19,413.90 Dollar të Amerikës .

Autoriteti i Likuidimit ka marr vendimin GJI031- 0003, dt. 03.10.2017, me të cilën e ka refuzuar si të pavlefshme kërkesën, ashtu që vendimi mbështetet në faktet dhe në bazën ligjore :

- Autoriteti i Likuidimit ka shqyrtuar kërkesën kreditore dhe provat e ofruara, ka konstatuar se nuk ato janë të mjaftueshme , ashtu që më dt. 18.04.2014, ja ka dërguar kërkesën, Parashtruesit për informata shtesë dhe prova . Paditësi e ka pranuar kërkesën e Autoritetit të Likuidimit dhe është përgjigjur në mënyrë të njejtë ,
- Paditësi nuk ka arritur që pranë Autoritetit të Likuidimit në mënyrë të plotë të argumentojë kërkesën me prova , dhe ky mos sukses është përsërit edhe pas kërkesës për informacione shtesë dhe prova ,
- Bazuar në këtë, kërkesa e paditësit mbeti e pa plotësuar edhe pas kërkesës për informata dhe prova shtesë . Kërkesa është refuzuar në bazë të nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 , i cili e obligon Autoritetin e Likuidimit ta refuzojë kërkesën nëse „ dokumentacioni për kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese ” .

Parashtresës në mbrojtje ja ka bashkangjitur si prova :

- Kopjen e Vendimit GJI031- 003,
- Kopjen e fletë dërgesës.

Më dt. 24.09.2020, i autorizuari i paditësit dorëzoi parashtresën e përgjigjes në mbrojtje të AKP-së, i cili ka mbetur pranë kërkesës për rivlerësim të Vendimit të Autoritetit të Likuidimit .

I autorizuari i paditësit në parashtresë ka ritheksuar se i tërë dokumentacioni i Bankës së Kosovës SHA në Beograd , pas vendosjes së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë gjatë vitit 1999, dhe pas nderimit të selisë së Bankës nga Prishtina në Beograd, ka mbetur në objektin afarist në Prishtinë dhe ka mundur që më vonë dokumentacioni të ndërroj lokacionin në një adresë në të cilën Banka e Kosovës nuk ka qasje.

Vlerësojmë se Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pasur për obligim të veprimi sipas nenit 48 të Ligjit për AKP-në dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe të siguroj dokumentacionin dhe jo ta refuzoj kërkesën si të pa vlefshme.

Pala paditëse jo vetëm që nuk e di lokacionin ku është vendosur dokumentacioni për Bakën e Kosovës, pala e paditur është në posedim të dokumentacionit që ka të bëjë me këtë kërkesë dhe kërkesat tjera të paditësit.

Kësaj parashtresa ja ka bashkangjitur si prova :

- Vërtetimin e lëshuar nga Agjencia për regjistrimin e bizneseve e Republikës së Serbisë , dt. 21.01.2014,
- Vendimin e Agjencisë për sigurimin e depozitave , sektori për falimentim, dt. 02.12.2013.
- Kopjen e ankesës së AKP-së, të ushtruar në Ministrinë e Financave në Republikën e Malit të Zi ,
- Kopjen e kontratës për shitblerje dt. , dt. 18.02.1972,
- Procesverbalin e dt. 29.09.2017, të hartuar në Gjykatën Themelore në Cetinje , Posl. P. nr. 16/17,

Më dt. 20.10.2020, AKP-ja përmes përfaqësuesit dorëzoi parashtresën e kundërpërgjigjes në përgjigje të mbrojtjes nga i autorizuari i paditësit. Me këtë parashtresë AKP-ja pretendon se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në mbrojtje .

Më dt. 19.04.2021, DHPGJS ka marrë Aktgjykim C- IV- 17- 0469, me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rivlerësim të Vendimit të AKP-së/ AL GJI 031- 0013, dt. 03.10.2013.

Më dt. 29.07.2022, Kolegji i Apelit ka marrë Aktvendim AC- I- 21- 0333- A 0001, me të cilin e ka prish Aktgjykimin C- IV- 17- 0469, dt. 19.04.2021 dhe rastin e ka kthyer në rigjykim.

Më dt. 15.08.2022, DHPGJS ka lëshuar Urdhër C- IV- 22- 0247, për paditësin dhe të njëjtit ju është urdhëruar të dorëzon listën e provave- dokumenteve në të cilat paditësi pretendon se ato gjenden te e paditura ose te peroni tjetër juridik . Mos dorëzimi i listës së provave do të ketë për pasoj juridike në lidhje me kërkesën , sipas parimit të barrës së provës .

Po ashtu edhe për të paditurën është lëshuar urdhër .

Më dt. 20.09.2022, i autorizuari i paditësit ka dorëzuar parashtresën dhe me të njëjtën është deklaruar se paditësi kërkon shumën 19,413.90 USD, kërkesa ka të bëjë për huan për bujqësi, për 12 komuna të pa zhvilluara, nr. 2306, nga e cila Banka ka lejuar kredi Kooperativës

Bujqësore „Orgosh” e cila do të duhet të kthehej në afatin prej 15 viteve, duke filluar prej viti 1984/1985, sipas kontratës për kredi nr. 05-19/XXV – II/3.

Ka theksuar se kontrata e cekur gjendet te e paditura, gjegjësisht te Agjencia Kosovare e Privatizimit e cila është duke zhvilluar procedurës e likuidimit .

Më dt. 29.08.2022, AKP –ja ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar se paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë dhe nuk ka argumentuar pretendimet e tija lidhur me kërkesën .

Më dt. 08.11.2022, DHPGJS ka lëshuar Urdhër për të paditurën AKP , për dorëzimin e provës që paditësi pretendon se e paditura e ka sipas parashtresë së dt. 15.09.2022.

Më dt. 22.11.2022, AKP-ja ka dorëzuar parashtresën, por me të cilën nuk është përgjigjur në Urdhër të gjykatës, në lidhje me dorëzimin provës së kërkuar. Në parashtresë e paditura është thirr në pretendimin se Kërkesa ju është bërë paditësit për informata shtesë , dhe ka dështuar të sjell dokumentet e kërkuara.

Më dt. 04.01.2024, DHPGJS përsëri ka lëshuar Urdhër për AKP-në.

Më dt. 01.02.2024, AKP-ja ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar se ka bërë përpjekje për të siguruar dokumentin por nuk ka arritur ta siguroi deri më tani.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për rishikim nuk është e bazuar .

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi procedurën kontestimore, Gjykata nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet në kërkesë të paditësit dhe në përgjigje në mbrojtje si dhe pretendimet e të paditurës në përgjigje dhe kundërpërgjigje, edhe pse asnjëra palë nuk kanë bashkangjitur asnjë provë materiale, që ka të bëjë me kërkesën kreditore për kthimin e kredisë në shumën e pretenduar 19,413.90 (\$) dollar Amerikan.

Gjykata vlerëson se Autoriteti i Likuidimit, para se të marrë vendimin e saj GJI0 031-003, ju ka drejtuar Parashtruesit të kërkesës për kthimin e kredisë me të cilën i ka kërkuar këto dokumentacione :

- 1) Kontratën për huan , në mes Bankës së Kosovës dhe NSH KB „ Përparimi ”,
- 2) Dëshminë mbi transferim e shumës së kryegjësë së huas ,
- 3) Dështimin për pagesat e NSH KB „ Përparimi ” ,
- 4) Planin e Kthimit të huas që nënkupton kthimin e kredisë dhe të kamatës ,
- 5) Sigurimin e provës me të cilën provoni se keni kërkuar mbrojtje në realizmin e kërkesës suaj dhe
- 6) Çdo provë tjetër që ka të bëjë me kërkesën .

Gjykata vlerëson se kërkesa për rishikim të Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, e ushtruar nga Paditësi nuk ka bashkangjitur asnjë provë të rëndësishme me të cilën provën krijimin e marrëdhënies juridike të kontratës për kredinë në mes Paditësit dhe të Paditurit, sikundër nuk ka

dorëzuar asnjë provë me të cilën provon se kontrata për kredinë është përmbushur nga paditësi, sikundër edhe gjendjen e kthimit të kredisë nga i padituri NSH KB „ Përparimi ”.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret barra e provës i përket Paditësit sipas nenit 31.5 lidhur 42.2 të Ligjit nr. 06/L086, e në lidhmëni me nenin 322 të LPK-së , në vërtetimin e fakteve me rëndësi siç është ekzistimi i marrëdhënies juridike të kontratës së kredisë, pastaj përmbushjen kontratës nga paditësi dhe mënyrën e kthimit të kredisë nga i padituri. Nuk ka asnjë provë se si ka rrjedh veprimi për kthimin e kredisë.

Gjykata vëren se edhe kërkesa në valutën në dollar Amerikan, e bënë të dyshimtë besueshmërinë e kërkesës për faktin se si valuta zyrtare në qarkullimin e brendshëm, para vitit 1999, në Kosovë ka qenë dinari, dhe jo valuta e ndonjë shteti tjetër , sikundër edhe çështje e llogaritjes së lartësisë së kërkesës .

Me dispozitën e nenit 36 të shtojcës së Ligjit për AKP-në, nr. 04/L-034 rregullohet :

„ 1. Autoriteti i Likuidimit refuzon, tërësisht apo pjesërisht, vlefshmërinë e Kërkesave apo interesit të pretenduar të kapitalit apo pronësisë nëse refuzimi i tillë obligohet apo lejohet sipas këtij ligji apo elementeve tjera të ligjeve të Kosovës në fuqi apo me urdhër të Gjykatës.

2. Pa kufizuar fushëveprimin apo zbatueshmërisë e paragrafit 1 më sipër, elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë:

2.1.kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme;

2.2.dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese; apo

2.3.ndonjë aspekt i dokumentacionit të paraqitur është mashtrues apo ka dëshmi të mira dhe dhe substanciale për të besuar se Kërkesa apo interesi i pretenduar është mashtrues ”

Gjykata vlerëson se meqenëse Paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë në lidhje me kërkesën e tij kreditore në procedurë të likuidimit, e cila kërkesë është dashur të mbështetet në ndonjë titull juridik (aktgjykim të formës së prerë) ose në dokumentacione të besueshme siç është kontrata e kredisë, plani i kthimit të kredisë duke përfshirë edhe periudhën kohore , kërkesa e paditësit është dashur të refuzohet.

Gjykata edhe në rigjykim është munduar të marrë informata në lidhje me provat që paditësi pretendon se gjenden te e paditura, por nuk ka arritur të njëjtat ti siguroi .

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, për mungesë të provave është refuzuar kërkesa e paditësit .

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti heqë shpenzimet e veta, pasi paditësi e ka humbur kontestin, ndërsa i padituri nuk i ka kërkuar shpenzimet .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva
Gjyqtar